# DËSHMI ARKIVI

**A-477438**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gjimshiti: San Marino nuk duhet nënvlerësuar, gjithçka varet nga përqendrimi ynë |
| ADRESA | `https://albeu.com/sport/gjimshiti-san-marino-nuk-duhet-nenvleresuar-gjithcka-varet-nga-perqendrimi-yne/1031612/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 19:01:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 18:57:48 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `4a094e84272d3066a598931b7394c4a1e73cf74498b1761a717742918af7ce11` |
| TEKSTI | `161fb6f54f818b8cacefbf8247a72d79930e81787892dff4d9e86e486ff3a650` |
| PAMJA | `11438a7cbcbe57d0a84adbf6b07933a2131c28fc44b9b66357d96a94335039c9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `073966cc0bf51c80faad582b0d58e1e03e2da38de75a4a54361371849eca4ecc` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `1fd94ce259103b5d3a93736e630fca63414b31f94ba022dd5b4f87109ff485e9` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/073966cc0bf51c80faad582b0d58e1e03e2da38de75a4a54361371849eca4ecc`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Gjimshiti: San Marino nuk duhet nënvlerësuar, gjithçka varet nga përqendrimi ynë




Berat Gjimshiti u kërkoi shokëve të skuadrës të mos e marrin lehtë sfidën ndaj San Marinos, duke nënvizuar se Kombëtarja duhet të hyjë në fushë me përqendrim maksimal dhe me mentalitetin e duhur.

Kapiteni i Shqipërisë bëri të ditur se objektivi i ekipit është përfundimi në vendin e parë të grupit. Sipas tij, kjo mund të arrihet vetëm nëse të gjithë futbollistët luajnë si një skuadër, me agresivitet, cilësi dhe angazhim të plotë gjatë 90 minutave.

**San Marino?** – Është e vërtetë që nuk është një ndeshje e thjeshtë. Përqendrimi duhet të jetë 100% në çdo takim, por veçanërisht në sfida të tilla, ku të gjithë presin që Kombëtarja jonë ta kontrollojë lojën.

Shumë njerëz mendojnë se do të jetë një përballje e lehtë, por nuk besoj se do të jetë aspak kështu. Në fund, gjithçka varet nga ne dhe nga mënyra se si do ta menaxhojmë ndeshjen. Përqendrimi duhet të jetë maksimal.

**Si kapiten, ku mendon se duhet të përmirësohet më shumë Kombëtarja jonë?** – Nuk kaluam një periudhë të mirë, por u rikthyem te fitorja dhe te ndeshjet me rëndësi të madhe. Liga e Kombeve na ofron një mundësi për të arritur në Europian. Mendoj se hapi i parë u bë në ndeshjen e fundit, ku luajtëm mirë dhe fituam me meritë.

Synimet tona janë të mëdha. Kërkojmë vendin e parë dhe për këtë duhet të përmirësohet i gjithë grupi, të luajmë së bashku dhe të japim maksimumin në fushë për 90 minuta. Në këtë nivel, një gabim i hershëm mund ta ndryshojë menjëherë rrjedhën e lojës, ndaj duhet të jemi të përqendruar.

**Çfarë duhet të bëjmë që të mos surprizohemi nesër nga San Marino?** – Duhet të zbresim në fushë me qasjen e duhur dhe të jemi 100% të përgatitur. Varet edhe nga mënyra se si do të luajë San Marino, por po aq rëndësi ka mënyra se si do të paraqitemi ne, me agresivitetin dhe cilësinë që zotërojmë.

Besoj se mund t'ia dalim të gjithë së bashku. Të rëndësishëm do të jenë si lojtarët që do të nisin ndeshjen, ashtu

të fundit/


Gjimshiti: San Marino nuk duhet nënvlerësuar, gjithçk…


Flakët përfshijnë barishte e kallamishte në Bishan të Vlorës,…


Brukseli përgatit një udhërrëfyes të posaçëm për…


Pas vdekjes së Mazonakis, mbyllet klinika në Selanik ku…


Kjo është përballja e fundit"/ Reklamat me Trump shkaktojnë…


Pesë të dyshuarit për komplot ndaj bazës amerikane në Angli…


Maran kërkon përqendrim maksimal ndaj San Marinos:…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

edhe ata që do të qëndrojnë në pankinë. Kjo duhet të jetë forca jonë.

**Kush të kanë kërkuar më shumë bileta për ndeshjen e nesërme, shqiptarët apo italianët?** – Këtë herë më ka kërkuar biletë një shoku im rumun, me të cilin kemi luajtur së bashku në Itali.

**I ke studiuar sulmuesit e San Marinos, çfarë veçantie mund të kenë si repart?** – E njoh sulmuesin Nanni, pasi kam luajtur kundër tij. Është një futbollist fizikisht i fuqishëm, pothuajse 1.90 metra i gjatë, njësoj si unë, dhe e mban shumë mirë topin.

Në Itali, kur nuk ke një ndeshje gjatë javës, zhvillon ndonjë miqësore me një ekip të Serisë C ose Serisë D. Në këto skuadra, sulmuesit ose numrat 10 zakonisht kanë më shumë cilësi. Prandaj nuk është e lehtë; ata kanë aftësi dhe duhet të jesh 100% i fokusuar, sepse në futboll mund të ndodhë gjithçka.

Shtuar më 28.09.2026 20:57

Tags: berat-gjimshiti , kombetarja , liga-e-kombeve , san-marino


Maran kërkon përqendrim maksimal ndaj San Marinos: Formacionin e…


Votimi për “Topin e Artë” mbyllet, fituesi i edicionit të vitit 2026 tashmë është…


Propozimi për dënimin e Man Cityt: zbritje 20-25 pikësh në sezon për deri …


Fitore historike e kombëtares sonë”, Fredi Beleri reagon për Greqin…


Kosova U21 përgatitet për Qipron me synimin për të marrë një tjetër fitore


Pas dy disfatave radhazi dhe thirrjeve për shkarkim, Ran Ben Shimon pret…


Finn Azaz po shqyrton largimin nga Irlanda pas sfidës me Izraelin


Rodrygo avancon drejt rikthimit te Real Madridi pas mbi gjashtë muajsh jasht…

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko… Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.